



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.36/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Agim Kastratit Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal Zgjedhor-KKZ në Kamenicë për shkak të pretendimit të pjesëmarrjes në tubim elektorale të subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) gjatë fushatës zgjedhore në Kamenicë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.36/2025 e datës 15.01.2025 e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Agim Kastrati Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal Zgjedhor - KKZ në Kamenicë për shkak të pretendimit të pjesëmarrjes në tubim elektorale të subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) gjatë fushatës zgjedhore në Kamenicë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 15.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se më 13.01.2025, rreth orës 19:00 Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Kamenicë ka vërejtur në rrjetin social facebook se anëtari i Komisionit Komunal Zgjedhor-KKZ nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, LDK, ka marrë pjesë në tubim elektorale të LDK-së të zhvilluar në Kamenicë në datën e njëjtë, në kundërshtim me dispozitat ligjore për zgjedhjet. Më tutje parashtruesi i ankesës e cek nenin 5, paragrafi 2.5 i Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, shprehimisht përcakton “*Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si në vijim: 2.5 anëtarët e KQZ, stafi i Sekretariatit të KQZ, Zyrës, KKZ, përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare*”.

Tutje parashtruesi i ankesës thekson se fillimisht më 13.01.2025 në faqen zyrtare të LDK-së, publikohet thirrja për pjesëmarrjen në tubimin politik në Kamenicë. Ndërsa po atë ditë, vetëm se në ora 16:12 është bërë thirrje për pjesëmarrje në tubim edhe dega e LDK-së në Kamenicë. Si dhe sipas parashtruesit të ankesës po atë ditë kryetari i LDK-së në rrjetin social facebook, ndanë një album me fotografi nga tubimi politik në Kamenicë, ku në këtë fotografi shihet se prezent në publik është po ashtu udhëheqësi i KKZ-së në Kamenicë, zoti Agim Kastrati, shihet fotografinë e dytë të këtij albumi.

Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se përmes këtij veprimi, subjekti dhe akterët përkatës, ka cënuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore, andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur si provë katër fotografi me linkun, <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1135129871315764&set=pb.100044562842177.-2207520000&type=3>,

<https://www.facebook.com/photo?fbid=1064716932357990&set=a.289551803207844>,

<https://www.facebook.com/photo?fbid=10161318623952759&set=pcb.10161318637337759>,

<https://www.facebook.com/photo?fbid=10161318623967759&set=pcb.10161318637337759>, si dhe në ankesë e ka paraqitur fotografinë tjetër që pretendon në pjesëmarrjen e Agim Kastratit në tubim elektoral, në cilësi të provës materiale.

Më datë 15.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 16.01.2025 në ora 12:00.

Më datë 15.01.2025, PZAP-i, e njoftoi KKZ/KQZ-Kamenicë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 16.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 16.01.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se sipas paragrafit 2.5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, shprehimisht përcakton se *“Në fushatën e zgjedhjeve nuk mund të përfshihen kategoritë e personave si në vijim: anëtarët e KQZ, stafit i Sekretariatit të KQZ, Zyrë, KKZ, përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare”*.

Tutje në përgjigje në ankesë theksohet paragrafi 2 dhe 3 të nenit 10 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve: par.2 *“KKZ duhet që aktivisht ta monitorojnë shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audiovizuale dhe të çfarëdo materiali tjetër zgjedhor të subjekteve politike të certifikuara, gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve.”* Par.3. *“Në rast të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për zgjedhjet, ose të dispozitave të përcaktuara 7 me LZP, apo rregulloret e KQZ, KKZ menjëherë duhet ta informojnë subjektin politik në fjalë që të marrë masa korrigjuese brenda njëzet e katër (24) orëve.”*

Në përgjigje në ankesë, po ashtu theksohet se subjekti politik i certifikuar Lidhja Demokratike e Kosovës, me datën 09.01.2024 në orën 10:18 ka dorëzuar në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve,

Formularin e Njoftimit për mbajtjen e tubimit. Tubimi është mbajtur me datën 13.01.2025, në Kamenicë, në restorant “Pëllumbi” dhe ky formular përmban nënshkrimin e ZE KKZ (Kryesuesi i KKZ) i pranuar në të njëjtën datë, 09.01.2025. Në këtë tubim përveç pjesëmarrjes së Kryesuesit të Kryesuesit Komunal të Zgjedhjeve, kanë marrë pjesë edhe dy anëtar tjerë të këtij komisioni Nexhmedin Korqa, anëtar i KKZ nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe Valdrin Krasniqi, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës. Përveç kryesuesit dhe dy anëtarëve të KKZ, në këtë tubim, pjesëmarrës kanë qenë edhe dy pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët kanë hartuar raportin e monitorimit të tubimit publik.

Në këtë mënyrë në bazë të neneve të lartcekura dhe dëshmime të bashkangjitura, konsiderojmë se monitorimi i këtij tubimi është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Si dëshmi për pretendimet e tij, në përgjigje në ankesë, ka bashkangjitur si provë, formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit, arsyetimin nga KKZ dhe Raportin e monitorimit të tubimit të LDK-së, nga Policia e Kosovës.

Pretendimi se me 13 janar 2025 anëtari i KKZ nga radhët e LDK ka marr pjesë në tubim elektoral në Kamenicë nuk qëndron cilën konsiderojmë se kjo i takon ankuesit që të bart barrën e provës (onus probandi), ngase në të tilla takime nuk ka identifikues (skaner) se kush merr pjesë apo jo, por edhe nëse qëndron një gjë e tillë nëni 5 paragrafi 2.5 ku edhe thirret subjekti politik LVV shprehimisht thotë : Në fushatën e zgjedhjeve nuk mund të përfshihen kategoritë e personave si në vijim: 2. 5. anëtarët e KQZ, stafi i Sekretariatit të KQZ, Zyrës, KKZ, përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare.

Pra, pjesa e fundit e dispozitës së lartcekur e sqaron edhe prezencën eventuale të tyre (përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare). Prezenca e ndonjë akteri të KQZ apo KKZ ka rol kontrollues e monitorues të mbarëvajtjes së takimit, por në rastin konkret të pretendimit të ankuesit nuk ka ndonjë prove konkrete për një gjë të tillë, pra për qëllimin e pjesëmarrjes eventuale.

Gjithashtu, pretendimi për pjesëmarrje të udhëheqësit të KKZ Kamenicë — Agim Kastrati mbetet barre prove për subjektin politik LVV, i njëjti nuk ka asnjë lidhje me subjektin politik LDK, andaj PZAP konsideroj që duhet të merr deklaratë zyrtare nga personi në gale, por që edhe Rregullorja nr. 07/2024, respektivisht nëni 4 paragrafi 8 shprehimisht thotë: KKZ është përgjegjës të jetë në koordinim të vazhdueshëm me policinë dhe të sigurojë informim të ndërsjellë por çdo shkelje eventuale të Kodit të Sjelljes nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre gjatë tubimeve publike, sipas Kapitullit të V të LZP. Raportet e policinë në lidhje me prishjen e ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion KQZ dhe PZAP. Çdo shkelje duhet që menjëherë të raportohet në PZAP dhe KQZ për veprim të mëtejshëm.

Marre parasysh nga ato që u cekën me lartë kërkojmë nga PZAP që të refuzoj ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje si të pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Me nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Rregullores Zgjedhore të KQZ-së Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, shprehimisht përcaktohet se *“Në fushatën e zgjedhjeve nuk mund të përfshihen kategoritë e personave si në vijim: anëtarët e KQZ, stafi i Sekretariatit të KQZ, Zyrë, KKZ, përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare”*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e Agim Kastratit Zyrtar Ekzekutiv i Komisionit Komunal Zgjedhor-KKZ në Kamenicë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përkrahura në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, pasi që Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-se ne Kamenice Agim Kastrati nuk ka marrë pjese në cilësin e pjesëmarrësit si përkrahës i partisë LDK në fushatën zgjedhore, kjo vërtetohet edhe nga fakti se me datën e lartpërmendur si ne ankesë i njëjti se bashku me zyrtaret e tjerë te KKZ ne Kamenice Nexhmedin Korqa anëtar i KKZ-së nga subjekti politik LVV dhe Valdrin Krasniqi anëtar i KKZ-së nga subjekti politik PDK kanë marrë pjesë në cilësinë e monitoruesve dhe të njëjtit po në atë tubim janë takuar me zyrtaret e Policisë se Kosove Stacioni Policor ne Kamenice Salih Mavriqin dhe Igballe Ramadani, në shkresën e nënshkruar nga ana e anëtarëve të KKZ ndër të tjera thuhet se *“Po në të njëjtin tubim, Unë jam takuar me zyrtarët e Policisë së Kosovës Salih Mavriqi dhe Igballe Ramadani të cilët janë caktuar nga Komandanti i Stacionit për bashkëpunim me KKZ, lidhur me monitorimin e tubimeve politike. Në fund të tubimit, unë si kryesues dhe dy policët kemi bërë vlerësimin e pjesëmarrësve në tubim...”*. Po ashtu në këtë shkresë ndër të tjera thuhet se : *“ Pjesmarresit ne tubimin politik nga ana e KKZ :*

1.Nexhmedin Korqa, antar i KKZ nga LVV

2. Valdrin Krasniqi, antar I KKZ nga PDK

3. Agim Kastrati, kryesues i KKZ ne Kamenice”.

Ndërsa në Raportin e monitorimit të tubimit politik Nr. Serik: 01 data e tubimit 13.01.2025 të Rajonit te Gjilanit Stacioni Policor në Kamenicë, me zyrtaret policer Salih Mavriqi#2346 dhe Igballe Ramadani#2656 ndër të tjera thuhet se *“Gjatë mbajtjes së këtij tubimi politik nuk ka pasur kurrfar incidenti të raportuar”*.

Në nenin 4 par.8 të *Rregullores Zgjedhore të KQZ-së Nr.07/2024* për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, në mënyrë deicidive thuhet se *“ KKZ është përgjegjës të jetë në koordinim të vazhdueshëm me policinë dhe të sigurojë informim të ndërsjellë për çdo shkelje eventuale të Kodit të Sjelljes nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre gjatë tubimeve publike...”*

Në nenin 10 paragrafi 2 të *Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024 të KQZ-së* në mënyrë deicidive thuhet se *“ KKZ duhet që aktivisht ta monitoroj shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audiovizuale dhe të çfarëdo materiali tjetër zgjedhor të subjekteve politike të certifikuara, gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve”*.

Andaj bazuar ne atë që u theksua si më lartë nuk mund të vërtetohet se i njëjti ka shkelur dispozita e sipër përmendura dhe Paneli ankesën e parashtruar e konsideron të pa bazuar në fakte, dëshmi të kjarta dhe bindëse konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 36/2025 më datën 17.01.2025

Kryesues i Panelit

Bujar Muzaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.